



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 12.01.2024

Nr: 03

Ora: 10:15

VENDIM

**PËR PUSHIMIN E SHQYRTIMIT TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 02 DATË 04.01.2024 TË DEPOZITUAR
NGA Z. EDISON MEMOLLA**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 12.01.2024, me pjesëmarrjen e:

| | | | |
|----------------|----------------|---|----------------|
| Ilirjan | RUSMALI | - | Relator |
| Elvin | LAKO | - | Anëtar |
| Elvis | ÇEFA | - | Anëtar |
| Koli | BELE | - | Anëtar |
| Ledio | BRAHO | - | Anëtar |

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: z. Edison Memolla, përfaqësuar me autorizim nga zj. Erinda Mamolla.

OBJEKT: Kundërshtim i vendimit nr. 824, datë 07.12.2023 “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e pjesshme vendore, të datës 6 Mars 2022”

BAZË LIGJORE: Nenet 21 pika 1 shkronja “b”, 123/1, 124, 129 dhe 130 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Subjekti ankues z. Edison Memolla, në cilësinë e kandidatit për kryetar të bashkisë Rrogozhinë për zgjedhjet e datës 06 Mars 2022, të subjektit “Partia Socialiste e Shqipërisë”, ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 02 regj., datë 04.01.2024.

Pas hedhjes së shortit, u zgjodh relator për shqyrtimin e çështjes z. Ilirjan Rusmali. Në mbledhjen e datës 12.01.2024, në zhvillimin e seancës paraprake, përfaqësuesja e ankuesit deklaroi se heq dorë nga kërkesa ankimore.

Kërkesa ankimore ka objekt kundërshtimin e vendimit nr. 824, datë 07.12.2023 “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e pjesshme vendore, të datës 6 Mars 2022”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, me të cilin ka vendosur ti kërkojë Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve të shqyrtojë dhe të vendosë sanksion ndaj subjekteve dhe kandidatëve për shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor, lidhur me raportimin.

Kandidati për kryetar të bashkisë Rrogozhinë për zgjedhjet e datës 06 Mars 2022 z. Edison Memolla, ka paraqitur kërkesë ankimore ndaj të njëjtit vendim. KAS-i konstaton se vendimet e kësaj natyre, nuk sjellin asnjë pasojë në interesat legjitime të subjekteve, sepse pasojat i sjell kërkesa e Komisionerit për vendosje sanksioni (*Kërkesa nr. 01, datë 08.01.2024*) dhe jo vendimi i tij për t’ju drejtuar KAS-it.

Në këto kushte, duke qenë se ankuesi ka hequr dorë tërësisht nga ankimi në këtë fazë të procedimit, në kuptim të nenit 142 të Kodit Zgjedhor, atëherë KAS duhet të vendosë pushimin e çështjes në tërësi.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 143, pika 1, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pushimin e shqyrtimit të kërkesës ankimore nr. 02, datë 04.01.2024, të paraqitur nga z. Edison Memolla në cilësinë e kandidatit për kryetar të bashkisë Rrogozhinë për zgjedhjet e datës 06 Mars 2022.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bazuar në pikën 1 të nenit 145 të Kodit Zgjedhor, kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 45 ditëve nga shpallja e tij, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 152 të Kodit Zgjedhor.

| | | | |
|----------------|----------------|---|----------------|
| Ilirjan | RUSMALI | - | Relator |
| Elvin | Lako | - | Anëtar |
| Elvis | Çefa | - | Anëtar |
| Koli | BELE | - | Anëtar |
| Ledio | BRAHO | - | Anëtar |